



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 28.05.2025  
Numër Protokolli: 3599/2025

A.nr.621/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar, me Flakron Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.621/2025 të datës 08.04.2025 të parashtruar nga ankuesja M.M.K, kundër organit të punësimit/Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.05.2025 mori:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa A.nr.621/2025, e datës 08.04.2025, e parashtruar nga ankuesja M.M.K.

## A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, M.M.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 08.04.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.621/2025, kundër organit të punësimit për shkak të mos kompensimit material sipas Aktit të Emërimit të datës 30.12.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 10.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit, me datë 15.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës Kryetari i Këshillit me datë 20.05.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:3286/2025, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjën A.nr.621/2025 të datës 08.04.2025

ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:** Ankesën me numër protokollit 2314/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 08.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 06.09.2025; Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokollit:3286/2025; Lista përfundimtare e kandidatëve të suksesshëm e datës 22.11.2024; Akt Emërimin e datës 30.12.2024; Vendimin e Këshillit A.nr.2110/2024 të datës 20.02.2025; Vendimin e datës 07.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Formualri për kërkesë të datës 26.03.2025; Vërtetimin e datës 02.04.2025 të Komunës së Gjilanit; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 08.04.2025; Përgjigje në ankesë e datës 15.04.2025; Vendimin e datës 07.03.2025 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit. Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Komuna e Gjilanit, më datë 06.09.2024 ka shpallur konkursin me numër reference RN00015031, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar për shërbime me qytetarë- Profesional 3”, për dy (2) vende të lira, ndërsa sipas Njoftimit të datës 22.11.2024 për rezultatet përfundimtare, konstatohet fakti se ankuesja ka dal kandidat e suksesshme, kurse organi i punësimit, Komuna e Gjilanit me datë 30.12.2024 ia ka lëshuar Akt Emërimin me shifër Nr.02/116-136634/24 sipas të cilit e njëjta ka themeluar marrëdhënien e punës me fillim që nga data 01.01.2025.

Mirëpo, ndaj procedurës së rekrutimit në të cilën kandidatja ka rezultuar të jetë e suksesshme, Këshilli me datë 27.12.2025 ka pranuar ankesën e ankueses A.Sh-H të cilën e njëjta e kishte parashtruar përmes postës me datë 20.12.2024. Këshilli në procedurë administrative e ka njoftuar organin e punësimit, Komunën e Gjilanit që ndaj konkursit me shifër reference RN00015031, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar për shërbime me qytetarë- Profesional 3”, është parashtruar ankesë, ndërsa me datë 20.02.2025 Këshilli ka nxjerrë Vendimin A.nr.2110/2024 me numër protokollit: 1144/2025 përmes të cilit e kishte aprovuar ankesën e ankueses A.Sh-H, ndërsa e kishte anuluar procedurën e rekrutimit në fjalë, pasi që kishte konstatuar shkelje të ligjit material, ndërsa sipas pikës III të dispozitivit, e kishte obliguar Njesisë e Burimeve Njerëzore që Vendimi i Këshillit A.nr.2110/2024 të zbatohet, duke anuluar procedurën përkatëse të rekrutimit.

Kryetari i Komunës së Gjilanit me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit, me datë 07.03.2025 kishte nxjerrë Vendimin Nr.321, përmes të cilit kishte vendosur që të anulohet procedura e rekrutimit shifër reference RN00015031, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar për shërbime me qytetarë- Profesional 3”, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 07.03.2025 nxjerrë Vendimin me shifër 02-016-18621/25 përmes të cilit e anulon akt emërimin e ankueses të datës 30.12.2024.

Ankuesja me datë 08.04.2025, parashtron ankesë në Këshilli me pretendimin ankimor që e njëjta të kompensohet për periudhën kohore nga data 01.01.2025 e deri me datë 07.03.2025, me pretendimin ankimor se e njëjta gjatë periudhës kohore respektive ka vijuar paraqitjen në punë, duke e mbështetur

pretendimin e saj edhe me Vërtetimin e datës 02.04.2025 të lëshuara nga Drejtoresha e DAP, në të cilën pasqyrohet fakti se ankuesja nga data 01.01.2025 e deri me datë 07.03.2025 ka punuar në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme në Gjiilan, në sektorin e Shërbimeve me Qytetar, pozita Zyrtar për shërbime me qytetarë.

Thënë si më lart dhe mbi bazën e konstatimeve ligjore, Kolegji i Këshillit mori përbazë dispozitat e aplikuara nga nenin 144 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.5 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet: *“1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës.”* ndërlidhur me nenin 130 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”* dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se Njoftimi i datës 22.11.2024 për kandidatët e suksesshëm është ekzekutuar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore të LPPA-së, të cekura si më lartë, pasi që për procedurën në fjalë ishte parashtruar ankesë dhe organi i punësimit ka qenë i njoftuar, gjegjësisht edhe Akti i Emërimit i datës 30.12.2024, ankueses i është lëshuar në mënyrë të paligjshme, dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses për kompensimin material nuk është i bazuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.621/2025, datë 28/05/2025

**Flakron GASHI**

Procesmbajtës

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses M.M.K;
- Komunës së Gjilanit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.